

NJOFTIM PËR TENDER



EMRI I TENDERIT:	SHËRBIME TË KANTINËS PËR NEVOJAT E BANKËS RAIFFEISEN NË KOSOVË
Referenca e tenderit:	T002 - 01/25
Data e hapjes:	29 Janar 2025
Shprehja e interesit:	10 Shkurt 2025
Vizite e hapesires:	11 - 12 Shkurt 2025
Pyetje/përgjigje:	13 – 14 Shkurt 2025
Data e mbylljes:	21 Shkurt 2025 saktësisht në orën 15:00
Lloji i Kontratës:	Marrëveshje për Shërbime
Autoriteti Kontraktues:	Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C. entitetet e saj dhe Raiffeisen Tech Kosovo

Shkurt 2025

Përmbajtja

1.	Informata të Përgjithshme	3
1.1	Qëllimi i këtij dokumenti	3
1.2	Informata për autoritetin kontraktues (Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C)	3
1.3	Afatet dhe Kushtet e Përgjithshme të Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.....	3
2.	Objektivi	4
2.1	Dizajnimin dhe furnizimin e hapësirës së restorantit me inventarin përcjellës:	4
2.2	Furnizimin me pajisje për ruajtjen e ushqimit përfshinë:.....	4
2.3	Përkufizimi i menysë:	5
3.	Higjiena, vlerësimi i performancës dhe kohëzgjatja e kontratës	6
3.1	Higjiena.....	6
3.2	Vlerësimi i performancës	6
3.3	Kohëzgjatja e kontratës.....	6
4.	Shprehja e interesit	7
5.	Kërkesat për ofertim teknik dhe financiar (II)	8
5.1.	Oferta financiare duhet të përmbajë detalet, si vijon:.....	8
5.2	Kushtet dhe rregullat e tenderit:	9
5.3	Komunikimi	9
6.	Ecuria e tenderit.....	10

1. Informata të Përgjithshme

1.1 Qëllimi i këtij dokumenti

Ky dokument ka për qëllim që të ofroj informatat e nevojshme pjesëmarrësve në këtë tender për mënyrën se si të dorëzojnë ofertën e tyre për funksionalizimin e kantinës në ndërtesën e zyrës qendrore të Raiffeisen Bank.

1.2 Informata për autoritetin kontraktues (Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C)

Banka Raiffeisen në Kosovë është degë e Raiffeisen Bank International AG (RBI). RBI erdhi në Kosovë në fund të vitit 2002 duke blerë pjesën më të madhe të aksioneve të Bankës Amerikane të Kosovës. Në qershor të vitit 2003, Banka u riemërtua si Banka Raiffeisen në Kosovë. RBI ofron shërbime dhe produkte bankare dhe investuese për kompanitë austriake dhe ndërkombëtare, një rrjet të gjerë të njësive bankare dhe lizing në Europën Qëndrore dhe Lindore për korporata dhe retail. Përveç kësaj, Grupi përbëhet nga shumë kompani të shërbimeve financiare, për shembull në fushën e leasing, menaxhimit të aseteve si dhe në fushën e blerjeve dhe shkrirjeve.

Sipas bilancit të gjendjes të datës 31 dhjetor 2023, asetet e përgjithshme të Bankës Raiffeisen në Kosovë ishin 1.298 milionë Euro, depozitat e klientëve 1.128 milionë Euro, ndërsa portofoli i kredive ishte 809 milionë Euro. Banka Raiffeisen ka një kapital prej 63 milionë Euro.

Banka Raiffeisen ofron një gamë të gjerë të shërbimeve dhe produkte bankare për të gjithë klientët: individët, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe të korporatave. Që nga fillimi i punës së saj në Kosovë, Raiffeisen Bank është shumë e suksesshme duke përkrahur zhvillimin e të gjitha segmenteve me produkte të ndryshme, duke përfshirë kreditë dhe depozitat.

Për të përkrahur aktivitetet tona të biznesit dhe për të ofruar shërbime të kualitetit të lartë për klientët tanë përmes teknologjisë më të re, ne kemi vazhduar të investojmë në Teknologji informative dhe operacione. Si vlerësim për këtë, banka jonë arriti të bëhet kompania e parë në rajon e certifikuar për ISO 20000 nga Registered Quality Assurance (LRQA).

Për më shumë informata rreth Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C., ju lutemi vizitoni:

<http://www.raiffeisen-kosovo.com>

1.3 Afatet dhe Kushtet e Përgjithshme të Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.

Ju duhet ta keni parasysh se me rastin e aplikimit në këtë tender dhe dorëzimit të ofertës financiare, keni lexuar e kuptuar paraprakisht si dhe pajtoheni me Kushtet dhe Termet e Bankës Raiffeisen në Kosovë që mund t'i gjeni në link në vazhdim:

[Afatet dhe Kushtet e Përgjithshme të Raiffeisen Bank Kosovo JSC](#)

2. Objektivi

Banka Raiffeisen në Kosovë është duke kërkuar kompani me reputacion në fushën e gastronomisë me qëllim të funksionalizimit të kantinës në ndërtesën e zyrës qendrore.

Me funksionalizim, Banka Raiffeisen nënkupton:

- *Dizajnimin dhe furnizimin e hapësirës së restorantit me inventarin përcjellës.*
- *Furnizimin me pajisje për ruajtjen e ushqimit dhe pijeve.*

2.1 Dizajnimin dhe furnizimin e hapësirës së restorantit me inventarin përcjellës:

- Plani i hapësirës është bashkëngjitur si Annex 1.
- Pajisjet mbesin në pronësi të operatorit.
- Hapësirat e restorantit ofrohen pa pagesë/qera mujore. Ky shpenzim mbulohet nga Banka, përfshirë ngrohjen, ftohjen, ventilimin, ujin dhe mbeturinat.
- Operatori gjatë gjithë kohës që ka kontratë me bankën duhet të dorëzojë pasqyrat financiare në baza vjetore.
- Operatori obligohet të ofroj të gjitha ushqimet e menysë së drekës në formë “delivery” sepse nuk lejohet përgatitja e ushqimit në objektin e bankës, për shkak të mungesës së infrastrukturës së nevojshme.
- Operatori obligohet të ofroj shërbime cateringu edhe në rast të organizimeve të ndryshme në hapësirat brenda bankës. Banka rezervon të drejtën që të angazhojë edhe operatorë të tjerë për qëllimin e njëjtë.
- Operatori nuk mund të na ngarkojë financiarisht në lidhje me shpenzimet operationale të stafit dhe menaxhmentit të vet.
- Operatori kujdeset që të ketë pika të mjaftueshme të pagesës me qëllim të reduktimit të pritjeve të gjata për shërbim.
- Operatori obligohet të ofroj shërbim të një standardi të lartë për pranuesit e shërbimeve (stafit të Bankës, vizitorëve të Bankës, etj.).

2.2 Furnizimin me pajisje për ruajtjen e ushqimit përfshinë:

- Aparatet e kafeve, frigoriferëve, enëve të kuzhinës dhe pajisjeve tjera përcjellëse për shërbim.
- Pajisjet duhet të jenë nga materiali që nuk është i dëmshëm për shëndetin.
- Ofrimin e ushqimit dhe pijeve të ngrohta dhe të ftohta jo-alkoolike sipas përkufizimit sipas pikës 2.3 Përkufizimi i Menysë
- Operatori obligohet që të gjithë pranuesve të shërbimit (stafit të bankës, vizitorëve të bankës, etj.) duhet të ju ofroj kualitet të ushqimit dhe shërbimit kundrejt një çmimi më konkurrues se ai që aktualisht është në treg.
- Operatori obligohet të ofroj të gjitha ushqimet e menysë në paketim kualitativ në mënyrë që ato të ruajnë freskinë dhe temperaturën sipas standardeve deri në shërbim (rekomandohet të bashkëngjitet foto e paketimit).
- Operatori duhet të jetë i pajisur me ndonjë platformë e cila do të ju mundësonte pranuesve të shërbimeve (stafit të Bankës) pagesën përmes ndonjë pajisjeje/ karteje e cila platformë më pas do të mundësonte gjenerimin e raporteve si dhe integrimin me sisteme tjera.

- Operatori kujdeset për pastërtinë dhe higjienën, që ajo të jetë adekuate dhe në përputhshmëri me kërkesat sanitare për hapësirën e restorantit. Në hapësirat e restorantit nuk është e lejuar pirja e duhanit.
- Operatori duhet të ketë po ashtu parasysh që:
 - Orari i punës në zyrat e Raiffeisen Bank është nga 07:30 deri në 16:30.
 - Në ndërtesën në fjalë janë rreth 600 punonjës gjatë ditës dhe dreka kryesisht konsumohet gjatë intervalit 11:00-14:00. Pijet dhe kafet konsumohen gjatë gjithë orarit të punës së zyrës qendrore.
 - Të kujdeset për sasinë e nevojshme të ushqimit që mund të konsumohet/porositet në baza ditore.
- Banka nuk merr përsipër të detyrojë personelin e vet që të shërbehen në këtë kantinë të ushqimit.

2.3 Përkufizimi i menysë:

- Kontraktori duhet të propozoj meny për ushqim/ drekë minimalisht për 5 (pesë) ditë të javës dhe rekomandohet të përmbajë sallatë ose supë, pjatën kryesore dhe dezert/ fruta. Menyja së bashku me çmimet duhet të jetë pjesë e ofertës.
- Për çdo ushqim të ofruar të shpalojë vlera përkatëse e kalorive dhe prezenca e substancave që shkaktojnë alergji.
- Ushqimet dhe pijet duhet të posedojnë certifikatë të kualitetit si p.sh. ISO 9001:2015, HACCP Method dhe/ose ndonjë certifikatë/licencë tjetër të disponueshme dhe të aplikueshme për këtë shërbim.
- Në ofertë duhet përfshirë informata mbi prejardhjen dhe prodhuesit e pijeve dhe ushqimit.

3. Higjiena, vlerësimi i performancës dhe kohëzgjatja e kontratës

3.1 Higjiena

- Operatori duhet të ju përmbahet të gjitha obligimeve Ligjore të Republikës së Kosovës në raport me kushtet higjienike/sanitare. Kjo është e aplikueshme gjatë përgatitjes, transportit dhe shërbimit.
- Operatori obligohet që të ofroj dëshmi mbi kushtet sanitare dhe higjienike sipas rregulloreve në fuqi.

3.2 Vlerësimi i performancës

- Vlerësimi i performancës së operatorit bëhet nëpërmjet pyetësorit të hartuar bashkërisht nga banka dhe operatori.
- Rezultati i këtij pyetësori që prodhon kënaqshmërinë duhet të jetë minimalisht 80%.

3.3 Kohëzgjatja e kontratës

- Banka Raiffeisen planifikon të përpilojë kontratë tri vjeçare me kompaninë e rekomanduar. Kontrata do të ketë mundësi vazhdimi nëse palët pajtohen.

4. Shprehja e interesit

4.1. Tenderi do të përfshijë dy faza. Në fazën e shprehjes së interesit kompanitë janë të obliguara të bashkëngjisin:

- Çertifikata e Regjistrimit të Biznesit.
- Dokumenti identifikues i pronarit të ndërmarrjes.
- Detajet tjera kontaktuese (adresa, numri kontaktues).
- Emrin, Mbiemrin dhe detajet kontaktuese të personit përgjegjës për këtë kërkesë.
- Referenca të lëshuara nga institucione me reputacion të lartë, që konfirmojnë se ofertuesit kanë ofruar shërbime të ngjashme apo kanë kryer në mënyrë të kënaqshme punë të ngjashme me ato të kërkuara me këtë dokument (jo më të vjetra se tre vite). Referencat të kenë të potencuar edhe një pike kontakti.
- Organogrami organizativ i ndërmarrjes përfshirë kualifikimet dhe numrin e personelit.
- Përshkrim i tri projekteve më të mira që janë realizuar lokalisht, duke specifikuar qartë të gjithë aktivitetin që kompania ka mbuluar në këto projekte.
- Prezantimi i kompanisë (duhet të ketë të paktën tre vite përvojë në tregun vendor).
- CV-të përkatëse të stafit.

4.2. Pas kualifikimit të kompanive në fazë të parë, kompanitë do të ftohen të dërgojnë ofertën e detajuar dhe financiare.

4.3. Kompanitë e interesuara mund të vizitojnë hapësirën ku do të jetë i vendosur restoranti dhe të shprehin interesimin përmes email.

4.4. Informatat duhet të bashkëngjiten në formatin elektronik në email:

prokurimi@raiffeisen-kosovo.com.

5. Kërkesat për ofertim teknik dhe financiar (II)

- **Banka Raiffeisen do të informoj kompanitë e kualifikuara nga faza e parë për të bashkëngjitur ofertën teknike dhe financiare në platformën elektronike, eSourcing.**
- Ju lutemi që ofertën tuaj ta dorëzoni brenda afatit të dhënë. Ofertat pranohen vetëm në platformë dhe sipas manualit që do të përcjellim përmes e-mail dhe eSourcing.
- Kompanitë e interesuara do të pranojnë e-mail me detaje dhe informata shtesë që lidhen me çasje në platformë.
- Oferta sipas specifikave të tenderit duhet të bashkëngjitet në platformën elektronike në formatin PDF (e nënshkruar dhe e vulosur). Kërkesat e lartëshënuara duhet të bashkëngjiten me ofertë.
- Oferta duhet të dorëzohet në valutën Euro dhe duhet të përfshijë TVSH. Në qoftë se çmimet dorëzohen pa e specifikuar TVSH, Banka do të konsiderojë se çmimet përfshijnë TVSH.

5.1. Oferta financiare duhet të përmbajë detalet, si vijon:

- Adresa e plotë dhe detajet kontaktuese të ofertuesit.
- Të përfshijë detajet e llogarisë bankare të ofertuesit.
- Të përmbajë numrin e ofertës.
- Të përmbajë datën e ofertës.
- Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë së paku 90 ditë nga dita e dorëzimit.
- Çdo faqe e ofertës duhet të vuloset dhe të nënshkruhet nga personi i autorizuar i kompanisë.
- Ofertës duhet t'i bashkëngjitet (kopje):
 - Çertifikata e Regjistrimit si pagues i TVSH-së.
 - Çertifikata e Numrit Fiskal.
- Dëshminë se kompania nuk ka borxhe ndaj autoriteteve vendore.
- Çertifikatat për prejardhjen e ushqimit.
- Dizajni i hapësirës së restorantit.
- Bilancin e vitit 2023.
- Menynë e ushqimit.
- Llojet e kafës dhe çajit
- Të bashkëngjiten çertifikatat që dëshmojnë pajtueshmërinë me:
 - Standardet mjedisore dhe/ose;
 - Konceptin për zhvillim të qëndrueshëm.
- Dokumentet e mësipërme të ngarkohen/ bashkëngjiten direkt në platformë në formatin PDF.

5.2 Kushtet dhe rregullat e tenderit:

- Ne ruajmë të drejtat për të ndryshuar specifikat, për të anuluar këtë tender, për të ftuar sërish pjesëmarrës të caktuar që ta dorëzojnë prapë ofertën e tyre dhe për të diskualifikuar cilindo ofertues pa dhënë njoftime paraprake apo arsye për këtë.
- Ne ruajmë të drejtat për të mos kontaktuar më ofertuesit gjatë procesit të tenderimit.
- Ofertat që nuk ju përmbahen kushteve të parashtruara në këtë dokument mund të diskualifikohen nga procesi i përzgjedhjes.
 - Të gjitha shpenzimet që ndërlidhen me përgatitjen e tenderit barten nga ofertuesi dhe asnjë shpenzim nuk do të mbulohet nga Banka. Informacionet e dhëna konsiderohen si informata të shpalosura pa pagesë.
 - Përzgjedhja e fituesit bazohet në vlerësimin e Komisionit të Tenderit dhe vendimin e Bordit Menaxhues.

5.3 Komunikimi

Komunikimet për këtë tender duke përfshirë fazën e pyetjeve dhe përgjigjeve duhet të bëhen në të shkruar dhe preferohet përmes e-mail.

Ju lusim që të drejtoni pyetjet tuaja tek departamenti i Prokurimit sipas detajeve në vijim:

Departamenti i Prokurimit
Rr. "Robert Doll", nr. 99, Prishtinë 10 000, Kosovë
Email: prokurimi@raiffeisen-kosovo.com

6. Ecuria e tenderit

Aktiviteti	Data	Përgjegjës
Publikimi i tenderit:	29 Janar 2025	RBKO
Afati i fundit për shprehje të interesit:	10 Shkurt 2025 (përmes e-mail: prokurimi@raiffeisen-kosovo.com)	Ofertuesit
Vizite e hapesires	11-12 Shkurt 2025	Ofertuesit
Pyetje dhe përgjigje:	13 – 14 Shkurt 2025 (përmes email: prokurimi@raiffeisen-kosovo.com)	Ofertuesit dhe RBKO
Hapja e platformës elektronike për kuotim:	18 Shkurt 2025 (përmes platformës elektronike e-Sourcing)	RBKO
Afati i fundit për dorëzim të ofertës financiare dhe teknike:	21 Shkurt 2025 saktësisht në orën 15:00 (përmes platformës elektronike e-Sourcing)	Ofertuesit
Njoftimet për ofertuesit:	Pas marrjes së vendimit	RBKO

➤ **Annex 1 – Hapësira dhe Planimetria e Kantinës**

